

URDHËR
Nr. 94, datë 25.2.2022

**PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE
AFATIN E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit do të jetë deri në datë 11.3.2022.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin anëtar të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA NR. 1

**NJOFTIM PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR
ARSIMIN, NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe urdhrit nr. 94, datë 25.2.2022, të MAS-it, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin Bujqësor të Tiranës, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin e Bujqësor të Tiranës, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1.	Universiteti Bujqësor i Tiranës	- 3 anëtarë përfaqësues të MAS-it - 1 anëtar i përkohshëm deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarrëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe të personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimi

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi e largimit nga detyra;
- të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;

- të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;

- të ketë integritet etik dhe profesional;

- të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

- të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

- të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- të njohë të paktën një gjuhë të huaj;

- të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit:

- kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL-ja ku kandidon;

- jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (*CV – Curriculum Vitae*);

- fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën *Bachelor*). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të diplomës/certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- fotokopje të librezës së punës;

- fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;

- vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga detyra;

- formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;

- vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;

- vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;

- vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 11.3.2022, në një nga këto mënyra:

a) me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të komisionit *ad hoc* të ngritur me urdhër ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit kryhet nga një komision *ad hoc*, i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatët e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: www.arsimi.gov.al.

7. Masa e shpërblimit

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në

Bordin e Administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1
VETËDEKLARIM MBI MOSANGAZHIMIN NË FUNKSIONE DREJTUESE
PARTIAKE

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordin Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrim _____

SHTOJCA NR. 1/2
VETËDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordin Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrim _____

SHTOJCA NR. 1/3
VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË
PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar Bordin në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrim _____